



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Nr.31, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor

Prof. dr. Marjan Dema

Nr. Prot.:

409

Datë:

7 / 2 / 2019


Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur me 10.01.2019, në përputhje me Rregulloren nr. 1/775, dt. 09.09.2014, për studime të doktoratës, mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohen listat e kandidatëve për pranim në studime të doktoratës, sipas propozimeve të njësive akademike dhe të Këshillit qendror të studimeve të doktoratës, në programet përkatëse të njësive akademike, mbi bazën e kritereve të konkursit publik nr. 3/217, dt. 18.10.2018.
- II. Kandidatët e pranuar në studimet e doktoratës për vitin akademik 2018/19, do të regjistrohen nga data 08.2.2019 deri më 20.2.2019.
- III. Regjistrimi dhe fotografimi i studentëve të pranuar bëhet në Administratën qendrore të universitetit (ndërtesa e Bibliotekës Qendrore Universitare).
- IV. Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:
  - Fletëregjistrimin të plotësuar (i cili shkarkohet nga SEMS);
  - Dy fotografi të formatit 6x4 cm;
  - Fletëpagesën (e cila shkarkohet nga interneti);
  - Pagesa bëhet në njërin prej bankave afariste.
- V. Data e fillimit të ligjëratave, caktohet nga njësitë akademike përkatëse.
- VI. Bashkëlidhur me këtë vendim janë pasqyrat me propozimet e njësive akademike.

Vendimi t'iu dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Shërbimit për çështje të studentëve në AQ;
3. Zyrës për çështje akademike;
4. Zyrës Ligjore të UP-së.
5. Dekanëve të Fakulteteve.



Rektori

Prof. dr. Marjan Dema